


LIBRI I ABSTRAKTEVE

KONFERENCA E TETË E SHËNDETIT,
MIRËQENIES, EDUKIMIT DHE TË DREJTAVE
TË FËMIJËVE



30 DHE 31 Maj 2025



Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësiore

LIBRI I ABSTRAKTEVE



RRETH KONFERENCËS

Me qëllimin kryesor të ofrimit të një platforme për shkëmbim njohjesh, idesh, praktikash dhe për diskutim të mirëfilltë të të gjeturave dhe trendeve më të reja në fushën e shëndetit, mirëqenies, edukimit dhe të drejtave të fëmijëve, Konferenca e Gjashtë e Shëndetit, Mirëqenies, Edukimit dhe të Drejtave të Fëmijëve vjen si pikëmbledhje për ekspertë, praktikues, politikëbërës, dhe hisedarë relevantë nga mbarë vendi dhe përtej.

Përmes synimit të kultivimit të një qasjeje multidisiplinare dhe gjithëpërfshirëse të adresimit të sfidave dhe çështjeve komplekse që prekin fëmijët dhe të rinjtë, dhe ofrimit të zgjidhjeve inovative që promovojnë shëndetin, mirëqenien, edukimin, dhe të drejtat e fëmijëve, ky edicion mundohet ta përkrahë aktivisht procesin e zhvillimit dhe implementimit të praktikave të bazuara në evidencë dhe programeve që promovojnë zhvillimin pozitiv të fëmijëve dhe të rinjve.

Trendet në rritje të ideacioneve dhe tentimeve për vetëvrasje tek adoleshentët në Kosovë: Një analizë kohore (2011–2024)

Prof. Dr. Aliriza Arënliu

Ky prezantim shqyrton rritjen e ideacioneve dhe tentim vetëvrasjeve të vetëraportuar nga adoleshentët në Kosovë, duke u bazuar në të dhënat nga Projekti Evropian për Studimin e Përdorimit të Alkoolit dhe Drogave të Nxënësit e Shkollave (ESPAD), i zbatuar nga Departamenti i Psikologjisë në Universitetin e Prishtinës. Gjatë tri valëve të studimit në vitet 2011, 2019 dhe 2024, ideacioni për vetëvrasje është rritur nga 7.8% në 20%, ndërsa tentimet për vetëvrasje nga 3.4% në 10%. Këto gjetje pasqyrojnë shqetësimet aktuale si në nivel rajonal ashtu edhe global për përkeqësimin e shëndetit mendor të adoleshentëve. Prezantimi do të përpiqet të “spekulojë” mbi disa nga faktorët që ndikojnë në këto trende, duke shqyrtuar gjetje të tjera hulumtimeve në Kosovë dhe jashtë saj. Mungesa e mekanizmave sistematik për parandalim dhe ndërhyrje të hershme rezulton me mbështetje të kufizuar për shumë adoleshentë në Kosovë gjatë periudhave të krizave emocionale. Këto rezultate nënvizojnë nevojën urgjente për investime në nivelin kombëtar në infrastrukturën e shëndetit mendor për të rinjtë, integrimin e shëndetit mendor në sistemin arsimor dhe ndërhyrje psikoedukative digjitale që i përshtaten nevojave të gjeneratave të reja. Duke krahasuar të dhënat me kontekste ndërkombëtare, prezantimi synon të theksojë cenueshmëritë unike të Kosovës dhe të hapë rrugë për hulumtime të mëtejme dhe strategji parandaluese multisektoriale.

Parandalimi i Sëmundjeve Kardiovaskulare: Një Sfidë Shkencore dhe një Përgjegjësi Sociale

Prof. Dr. Gani Bajraktari

Sëmundjet kardiovaskulare (SKV) vazhdojnë të jenë shkaku më i zakonshëm i vdekjes në mbarë botën, përgjegjëse për rreth 18 milionë jetë të humbura çdo vit. Pavarësisht përparimeve të konsiderueshme mjekësore, numri në rritje i rasteve vazhdon të nxitet kryesisht nga faktorë rreziku të parandalueshëm, si dieta e dobët, stili i jetesës sedentare, pirja e duhanit, hipertensioni, kolesterolit i lartë, mbipesha dhe diabeti.

Ky studim paraqet parimet kryesore të parandalimit të SKV-ve në një mënyrë të qasshme për publikun jo-mjekësor, duke i ndarë ato në tre nivele të parandalimit:

- Parandalimi fillestar synon të ndalojë zhvillimin e faktorëve të rrezikut që në fillim, përmes edukimit dhe ndërtimit të zakoneve të shëndetshme që në fëmijëri.
- Parandalimi parësor u drejtohet individëve që tashmë shfaqin faktorë rreziku, por nuk kanë zhvilluar ende sëmundjen, duke inkurajuar ndryshimin e stilit të jetesës dhe trajtimin mjekësor kur është e nevojshme.
- Parandalimi dytësor përqendrohet tek ata që kanë përjetuar një ngjarje kardiovaskulare, me qëllim parandalimin e përsëritjes përmes medikamenteve, rehabilitimit dhe menaxhimit të vazhdueshëm të faktorëve të rrezikut.

Përtej kujdesit klinik, parandalimi i sëmundjeve të zemrës kërkon angazhim të gjerë shoqëror. Politikat e shëndetit publik, sistemet arsimore, iniciativat në vendin e punës dhe mbështetja e komunitetit luajnë role kyçe. Prandaj, parandalimi nuk është vetëm përgjegjësi e mjekëve; është një sfidë ndërdisiplinore që prek të gjithë sektorët.

Veprime të thjeshta, si nxitja e aktivitetit fizik të përditshëm, ulja e konsumit të kripës dhe sheqerit, menaxhimi i stresit dhe krijimi i mjediseve pa tym duhani, mund të kenë ndikim të madh nëse zbatohen në shkallë të gjerë.

Përmes ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së zgjedhjeve të shëndetshme në përditshmëri, secili prej nesh mund të ndihmojë në uljen e barrës së SKV-ve. Ky studim fton kolegët nga të gjitha fushat akademike të reflektojnë mbi mënyrat se si edhe ata mund të japin kontribut në këtë përpjekje jetike për përmirësimin e shëndetit publik.

Interesi Më i Mirë i Fëmijës

Realizimi Praktik i të Drejtave të Fëmijëve

Prof. Dr. Qerim Qerimi

Ky prezantim synon të paraqesë mënyrën se si të drejtat ndërkombëtare të fëmijëve dhe parimi themelor i “interesit më të mirë të fëmijës” gjejnë zbatim konkret në rendin juridik të Kosovës. Përveç e përtej kornizës kushtetuese e ligjore, ky diskutim do të përqendrohet në një rast konkret jetësor e gjyqësor, që ka rezultuar në një Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (rasti nr. KI161/21). Rasti përfshin trajtimin e pretendimeve për dhunë në familje dhe implikimet e tyre ndaj nënës dhe fëmijës, duke sfiduar qasjen e tri shkallëve të gjykatave të rregullta, përfshirë Gjykatën Supreme, të cilat u shpallën në kundërshtim me Kushtetutën nga ana e Gjykatës Kushtetuese për mosrespektimin e standardeve të procesit të rregullt dhe të mbrojtjes efektive të të drejtave themelore.

Gjykata Kushtetuese, për herë të parë në mënyrë shprehimore, vlerësoi situatën nga perspektiva e të drejtave të fëmijës, duke vendosur për nevojën e mbrojtjes së fëmijës si dëshmitar i dhunës dhe ndikimin që kjo ka në formësimin e drejtësisë. Prezantimi vë në dukje boshllëqet sistematike në zbatimin e parimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, veçanërisht në lidhje me ballafaqimin e fëmijës me procedurat gjyqësore, shpërfilljen ndaj dëshmive të dhunës së mëhershme dhe mungesën e vlerësimeve të duhura psiko-sociale.

Përveç analizës juridike, ky prezantim synon të kontribuojë në ndërgjegjësimin profesional dhe shoqëror për rëndësinë e integritet të “interesit më të mirë” të fëmijës si standard interpretues, vlerësues dhe vendimmarrës në çdo fazë të procedurave gjyqësore ose proceseve të tjera të ndërlidhura institucionale. Ky rast paraqet një shembull të vlefshëm për të reflektuar mbi detyrimet institucionale dhe për të propozuar qasje sistematike për mbrojtjen më të mirë të fëmijëve në sistemin ligjor e institucional.

Fillon në Shtëpi: Ripërfytyrimi i Ndërhyrjeve të Hershme me Familjet në Qendër

Prof. As. Dr. Blerta Perolli Shehu

Ky prezentim thekson rolin kritik të Ndërhyrjes së Hershme të bazuar në Familje (ECI) për fëmijët me nevoja të veçanta zhvillimore në Kosovë. Mbështetur në parimin se ndërhyrjet e hershme janë më efektive kur janë pjesë e jetës së përditshme të familjes dhe në rutinat e fëmijëve, prezentimi eksploron një qasje të personalizuar dhe të qëndrueshme që vendosë familjen në qendër të zhvillimit të fëmijës.

Duke u bazuar në analizat më të fundit të situatës së ECI-së në Kosovë, identifikohen pengesat strukturore kryesore dhe mundësitë për përmirësim të shërbimeve. Po ashtu, ndahen gjetjet paraprake nga një iniciativë në pilotim që zbaton qasje të ndërhyrjes së hershme të orientuar nga familja në bashkëpunim me ekipet mobile. Këto të dhëna nënvizojnë potencialin transformues të modeleve të fokusuar te familja – jo vetëm në përmirësimin e zhvillimit të fëmijës, por edhe në fuqizimin e kapaciteteve të familjes dhe komunitetit.

I mbështetur në literaturën bashkëkohore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, ky prezentim ofron rekomandime konkrete për integrimin e ECI-së në politikat publike dhe praktikat profesionale në Kosovë. Synohet nxitja e një dialogu të hapur dhe reflektimi mbi mënyrën se si mund të ndërtojmë sisteme gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të kujdesit të hershëm, duke vendosur familjen në zemër të çdo ndërhyrjeje për të siguruar fillime të drejta dhe domethënëse për çdo fëmijë.

Antibiotikët: Shokë apo Armiq të Shëndetit të Fëmijëve?

Prof. As. Dr. Lul Raka

Hyrje: Antibiotikët janë aleatët tanë kryesorë në trajtimin e infeksioneve bakteriale tek fëmijët. Megjithatë, përdorimi i tyre i panevojshëm po ushqen një armik të padukshëm: rezistencën antimikrobike. Në vend që të mbrojnë, antibiotikët mund të bëhen të pafuqishëm, duke na kthyer në kohën para Aleksandër Flemingut.

Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të analizojë botën e ndërlikuar të antibiotikëve tek fëmijët, duke eksploruar përshkrimin dhe përdorimin e tyre dhe duke propozuar zgjidhje për një të ardhme më të sigurt.

Metodologjia: Studimi përfshin një rishikim të literaturës shkencore mbi përdorimin e antibiotikëve tek fëmijët, shqyrtimin e udhëzimeve klinike ekzistuese dhe një vlerësim të të dhënave mbi përshkrimin e antibiotikëve. Gjithashtu, analizon faktorët që ndikojnë në përshkrimin e antibiotikëve, përfshirë qëndrimet e mjekëve dhe frikën e prindërve, të cilët në dëshirën për të ndihmuar fëmijët e tyre, pa dashje kontribuojnë në këtë sfidë madhore të shëndetit publik.

Rezultatet e pritshme: studimi do të identifikojë një shkallë të lartë të përshkrimit empirik të antibiotikëve tek fëmijët, veçanërisht për infeksione virale. Do të diskutohen gjithashtu strategjitë për uljen e keqpërdorimit, përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit tek profesionistët shëndetësorë dhe edukimin e prindërve.

Përfundime: Në epokën tonë, zbatimi i programeve të përdorimit racional të antibiotikëve dhe rritja e ndërgjegjësimit te stafi shëndetësor dhe publiku, nuk janë më opsione – janë domosdoshmëri. Ato mund të sigurojnë që antibiotikët të mbeten një armë e fuqishme dhe jo relikte të së kaluarës.

Fjalë kyçe: Antibiotikët, fëmijët, rezistenca antimikrobike, përdorimi racional i antibiotikëve

Efektiviteti i Dhënies së Komandave Përmes Videove për të Mësuar Lojërat e Mendjes tek Individët me Çrregullim të Spektrit të Autizmit

Prof. As. Dr. Ümit Savaş Taşkesen

Aktivitetet gjatë lojës kanë rol thelbësor në zhvillimin e aftësive sociale tek individët me Çrregullim të Spektrit të Autizmit (ÇSA). Ky studim shqyrtoi efektivitetin e zbatimit të video-nxitjes në mësimdhënien e aftësive të lojërave mendore tek individët e diagnostikuar me ÇSA. Hulumtimi përdori një model kërkimi me një subjekt të vetëm, konkretisht "Dizajn me Sondazhe të Shumëfishta me Seanca Sondazhi midis Pjesëmarrësve". Tre fëmijë të diagnostikuar me ÇSA (një femër, dy meshkuj) morën pjesë në studim. Pjesëmarrësve iu mësuan tre lojëra mendore të ndryshme. Rezultatet treguan se të gjithë pjesëmarrësit mësuan me sukses të luanin lojërat mendore sipas rregullave përmes video-nxitjes. Aftësitë e fituara u përgjithësuan me sukses në ndërveprime me persona dhe mjedise të ndryshme, me një saktësi prej 100%. Vlerësimet e ruajtjes së aftësive, të realizuara pas 1, 2 dhe 4 javësh nga përfundimi i instruksionit, treguan një ruajtje të plotë (100%) të këtyre aftësive. Të dhënat e vlefshmërisë sociale zbuluan se familjet dhe edukatorët e perceptuan këtë ndërhyrje si efektive dhe e gjetën mësimdhënien e lojërave mendore të dobishme, duke i përfshirë më pas këto metoda në programet e tyre arsimore. Këto gjetje sugjerojnë që nxitja me video përfaqëson një qasje efektive metodologjike për mësimdhënien e lojërave mendore tek individët me Çrregullim të Spektrit Autik. Ky prezantim do të ofrojë gjithashtu vëzhgime dhe vlerësime cilësore në lidhje me procesin e mësimdhënies së lojërave mendore tek fëmijët me autizëm, qëndrimet prindërore para dhe pas zbatimit, dhe trajektoret zhvillimore të fëmijëve pjesëmarrës gjatë një periudhe ndjekjeje katërvjeçare.

Fjalë kyçe: Çrregullim i spektrit të autizmit, lojëra mendore, nxitje me video, aftësi loje, aftësi sociale

Studimi mbi Përshtatjen, Vlefshmërinë dhe Besueshmërinë e "Shkallës së Varësisë nga Interneti për Adoleshentët" në Gjuhën Shqipe

Dr. Sc. Naim Telaku

Qëllimi i këtij studimi ishte verifikimi i përmasave të varësisë nga interneti në gjuhën shqipe. Në këtë studim u përdor "Shkalla e Varësisë nga Interneti për Adoleshentët" për të përcaktuar varësinë nga interneti. Për verifikimin e ekuivalencës gjuhësore, shkalla iu administrua 164 studentëve universitarë të Fakultetit të Psikologjisë në Kolegjin AAB dhe 61 nxënësve të shkollës së mesme në British School of Kosovo (në total 245 pjesëmarrës). Koeficienti i qëndrueshmërisë së brendshme sipas Cronbach Alpha rezultoi të ishte .828. U vërejt se vlerat e ngarkesës faktoriale të artikujve të shkallës varionin nga .56 deri në .72. Koeficienti Kaiser–Meyer–Olkin (KMO) ishte .82, ndërsa testi i sfericitetit i Bartlett-it rezultoi domethënës, $\chi^2(1) = 605.87$, $p < .001$. Në analizën konfirmuese faktoriale u konstatua se struktura një-dimensionale e shkallës ofroi përshtatje të mirë: $\chi^2(26) = 63.17$, $\chi^2/df = 2.42$, RMSEA = .077, RMR = .069, SRMR = .049, GFI = .95, AGFI = .91, CFI = .94, NNFI = .90, IFI = .94. Gjetjet e marra nga analiza e vlefshmërisë faktoriale dhe besueshmëria e shkallës tregojnë se shkalla në gjuhën shqipe është e vlefshme dhe e besueshme

Shëndeti dhe Mirëqenia e të Rinjve Përmes Edukimit Gjithëpërfshirës Seksual: Proceset, Arritjet dhe Sfidat në Kosovë

Dr. Zarife Miftari, Visare Mujko Nimani, Besnik Sherifi

HYRJE Edukimi gjithëpërfshirës seksual (EGS) është i mbështetur nga Udhëzimi Teknik Ndërkombëtar për Edukimin Seksual i UNESCO-s dhe luan një rol kryesor në përgatitjen e të rinjve për një jetë të sigurt, produktive dhe të përmbushur. Në Kosovë, EGS është përfshirë në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës që nga viti 2010.

QËLLIMI Ky punim paraqet proceset, arritjet dhe sfidat e zbatimit të EGJS në sistemin arsimor parauniversitar të Kosovës.

MATERIALE DHE METODA Kosova ka avancuar EGJS përmes reformës kurrikulare të udhëhequr nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në partneritet me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe të mbështetur nga UNFPA. Hapat kryesor përfshinin përshtatjen e standardeve evropiane të EGJS, zhvillimin e materialeve mësimore për klasat 0-12 (duke përfshirë burimet gjithëpërfshirëse), trajnimin e mësuesve dhe krijimin e mjeteve ndërgjegjëse për nxënësit dhe prindërit.

REZULTATET Manualët e mësuesve u përshtatën për të ofruar në mënyrë efektive CSE-në, duke adresuar nevojat unike dhe nivelin e të kuptuarit të nxënësve nga nivelet 1-5, 6-9 dhe 10-12; është zhvilluar një manual për mësuesit që punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe 12 video për secilin nivel dhe një broshurë mbi rëndësinë e CSE-së për prindërit. 2,807 mësues janë trajnuar përmes mbështetjes së UNFPA-së. Materialet e CSE-së u integruan në tre programe bachelor (parashkollor, arsim fillor dhe pedagogji e përgjithshme) dhe tre programe studimi master (Mësimdhënia e Biologjisë, Arsimi Gjithëpërfshirës dhe Pedagogjia).

Në nëntor 2024, Kosova përjetoj tensione të konsiderueshme politike dhe kulturore rreth futjes së CSE-së në shkolla. Kritikët argumentuan se këto materiale ishin të papërshtatshme dhe nuk përputheshin me vlerat kulturore të Kosovës, duke çuar në një debat të gjerë.

PËRFUNDIM Kjo qasje shumëpalëshe nënvizon angazhimin e Kosovës për të siguruar që të rinjtë e saj të jenë të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të marrë vendime të informuara në lidhje me shëndetin e tyre seksual. Pavarësisht sfidave dhe kundërshtimeve nga segmentet konservatore, Kosova mbetet një histori suksesi në zbatimin e edukimit gjithëpërfshirës seksual (ESS) në rajon.

FJALË KYÇE Edukimi gjithëpërfshirës seksual, Shkollat, Kosova.

Qasjet dhe Sfidat e Mësuesve në Punën me Nxënësit me Nevoja të Veçanta në Arsimin Fillor – Sfidat dhe Mundësitë në Maqedoninë e Veriut

Prof. Dr. Lulzim Mehmedi

Arsimi gjithëpërfshirës përfaqëson një të drejtë themelore të njeriut dhe një gur themel për sigurimin e mundësive të barabarta për të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevoja të veçanta arsimore. Ky punim ofron një analizë gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale të praktikave gjithëpërfshirëse në Maqedoninë e Veriut, me një fokus të veçantë në sfidat me të cilat përballen mësuesit e shkollave fillore. Përmes një shqyrtimi të kornizave të fundit ligjore, politikave strategjike dhe reformave arsimore të zbatuara nga viti 2018 deri në vitin 2025, studimi nxjerr në pah zhvillimet kryesore në kalimin e vendit nga një sistem i dyfishtë arsimor drejt një modeli plotësisht gjithëpërfshirës. Të dhënat empirike u mbledhën përmes një analize përshkruese dhe krahasuese të legjisllacionit kombëtar, raporteve qeveritare dhe gjetjeve të fundit të hulumtimit. Gjetjet zbulojnë se, pavarësisht përparimit të politikave, mësuesit e shkollave fillore vazhdojnë të përballen me pengesa të konsiderueshme. Këto përfshijnë trajnim të pamjaftueshëm profesional në pedagogji gjithëpërfshirëse, qasje të kufizuar në materiale didaktike adaptive dhe bashkëpunim të pazhvilluar ndërprofesional me edukatorët specialë dhe asistentët arsimorë. Megjithatë, studimi identifikon edhe trende pozitive, siç janë qëndrimet gjithnjë e më të favorshme të mësuesve ndaj përfshirjes dhe një njohje gjithnjë e më e madhe e rëndësisë së mbështetjes individuale. Dokumenti përfundon me rekomandime për programe të qëndrueshme trajnimi për mësues, zhvillimin e materialeve mësimore të përshtatshme për kontekstin dhe institucionalizimin e praktikave bashkëpunuese midis mësuesve, specialistëve dhe familjeve. Adresimi i këtyre sfidave mbetet thelbësor për të siguruar përfshirje kuptimplotë dhe arsim të barabartë për të gjithë fëmijët në Maqedoninë e Veriut.

Prof. As. Dr. Gentrit Berisha

Më trego i sati fëmijë je të tregoj se kush je si menaxher

Shumë kohë përpara dhe në mënyrë të pavarur nga shkenca, kanë ekzistuar stereotipe dhe anekdota për fëmijët sipas rendit të tyre të lindjes. Interesi për rendin e lindjes dhe ndikimin në sjellje, veprime dhe rezultate është aq intuitivisht tërheqës, sa që eventualisht është bërë fokus i kërkimeve. Përkundër kritikave për probleme konceptuale dhe metodologjike, rendi i lindjes vazhdon të përdoret gjerësisht si një variabël e pavarur në shkencat sociale. Madje, konsiderohet se si një parashikues më i mirë i qëndrimeve shoqërore sesa gjinia, klasa apo raca. Nami i rendit të lindjes ka arritur edhe në menaxhment dhe ndërmarrësi.

Studimi sjell një përmbledhje të rezultateve të përpjekjeve shkencore për të shpjeguar fenomene në fushën e menaxhmentit përmes këndvështrimit të rendit të lindjes. Po ashtu, studimi përmbledh rezultatet e dy hulumtimeve me mostra të menaxherëve kosovarë, të cilët kanë raportuar për qëndrimet, synimet, sjelljet dhe veprimet e tyre në punë, me mëtimin për t'u dhënë shpjegim përmes rendit të lindjes si diferencë biologjike dhe sociale. Duke qenë mes variablave më të pavarura, rendi i lindjes shpjegon diferenca në prirjen ndërmarrëse, trajtimin e konfliktit, lidërshtipin etik, sjelljen inovative dhe manifestime të tjera të individit në vendin e punës.

Përdorimi i Chatbot-eve në Fushën e Kujdesit Shëndetësor duke përdorur Deep Learning dhe IA Neuro-Simbolike

Prof. As. Dr. Krenare Nuçi Pireva

Integrimi i chatbot-eve në fushën e kujdesit shëndetësor ka revolucionarizuar kujdesin, mbështetjen dhe diagnostikimin e pacientëve përmes automatizimit dhe ndërveprimit inteligjent. Ky punim eksploron rolin e zhvillimit të chatbot-eve të mundësuar nga Mësimi i Thellë (DL) dhe Inteligjenca Artificiale Neuro-Simbolike (NSAI), duke theksuar potencialin e tyre për të ofruar përgjigje të vetëdijshme për kontekstin dhe për të përmirësuar vendimmarrjen klinike. Mësimi i Thellë u mundëson chatbot-eve të përpunojnë të dhëna mjekësore të pastruara, të tilla si historitë e pacientëve dhe shënimet klinike, ndërsa NSAI mbush hendekun midis të mësuarit statistikor dhe arsytimit simbolik, duke përmirësuar interpretueshmërinë dhe besueshmërinë në aplikimet mjekësore. Në këtë studim, analizojmë arkitektura të ndryshme të chatbot-eve, diskutojmë sfida të tilla si privatësia e të dhënave, paragjykimi dhe shpjegueshmëria, dhe shqyrtojmë raste përdorimi që variojnë nga mbështetja e shëndetit mendor deri te diagnostikimi paraprak. Studimi thekson se si kombinimi i DL dhe NSAI mund të kapërcejë kufizimet e modeleve tradicionale të IA-së, duke çuar në zgjidhje më të fuqishme, transparente dhe të besueshme të kujdesit shëndetësor. Kornizat mbizotëruese të IA-së të përdorura janë modelet sekuencë-në-sekuencë, modelet e bazuara në vëmendje dhe arkitekturat transformuese, me grupe të dhënash që përdoren shpesh të tilla si MultiWoZ, SimDial dhe Taskmaster. Përveç kësaj, studimi përfshin një analizë të rasteve të Pi, Poe, Personal.ai dhe Woebot - chatbot personalë të shëndetit mendor të IA-së të dizajnuar për adoleshentë dhe prindër që shfrytëzojnë teknikat e terapisë CBT për të ofruar mbështetje dhe udhëzime emocionale. Këta chatbot ilustrojnë se si kombinimi i DL dhe NSAI mund të angazhojë në mënyrë efektive përdoruesit duke ofruar përgjigje të personalizuar, duke ruajtur privatësinë e të dhënave dhe sigurinë emocionale. Gjetjet theksojnë se kalimi nga IA tradicionale në IA Neuro Simbolike mund të zbusë kufizimet në modelet tradicionale të IA-së, duke çuar në sisteme chatbot më të fuqishme, transparente dhe të besueshme të kujdesit shëndetësor.

Zhvillimi i hershëm i fëmijës dhe roli kritik i informimit prindëror: një perspektivë klinike

Dr. Violeta Zefi

Kujdesi prindëror në fazat e hershme të zhvillimit është një determinant thelbësor për mirëqenien biopsikosociale të fëmijës, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin kognitiv, emocional dhe social. Ky prezantim shqyrton ndikimet shumëdimensionale që rrjedhin nga mungesa e informimit adekuat të prindërve lidhur me zhvillimin e fëmijërisë së hershme, si dhe pasojat afatshkurtra dhe afatgjata mbi shëndetin mendor të fëmijës. Nëpërmjet analizës së literaturës bashkëkohore dhe vëzhgimit të sjelljeve prindërore në kontekstin klinik, identifikohen problematika kyçe të tilla si përdorimi i strategjive joefektive të prindërimit, pritshmëritë e paharmonizuara me kapacitetet reale të fëmijës, si dhe ekspozimi i hershëm dhe i pakontrolluar ndaj teknologjisë digjitale. Mungesa e informacionit të saktë dhe burimeve jo të besueshme çon në vendimmarrje prindërore të bazuara në perceptime jo-shkencore, duke rezultuar në çrregullime të sjelljes, nivele të larta të ankthit, vështirësi në të nxënë dhe dobësim të aftësive të ndërveprimit social. Për më tepër, hezitimi për të kërkuar ndihmë profesionale në kohën e duhur amplifikon problemet ekzistuese, duke reduktuar efektivitetin e ndërhyrjeve terapeutike. Prezantimi thekson rëndësinë kritike të ndërgjegjësimit dhe edukimit të prindërve mbi aspektet neurozhvillimore të fëmijës, rëndësinë e prindërimit të bazuar në evidencë shkencore, si dhe nevojën për bashkëpunim të ngushtë me profesionistët e shëndetit mendor dhe zhvillimit, si psikologët klinikë. Në përfundim, prezantimi sugjeron ndërhyrje të strukturuar dhe programe edukimi prindëror me qëllim fuqizimin e prindërve për të ofruar një mjedis mbështetës, të sigurt dhe të favorshëm për zhvillimin e fëmijës.

Për një Rrjetë Bashkëkohorë të Sigurisë për Mirërritjen e Fëmijëve

Dr. Sami Uka

Zhvillimi i shëndetshëm i fëmijëve kërkon një rrjet mbështetës të integruar, që lidh kujdesin shëndetësor, edukimin dhe përkujdesjen familjare. Mjekët familjarë kanë rol thelbësor në këtë proces përmes vrojtimeve zhvillimore të hershme dhe bashkëpunimit me prindërit, mësuesit, logopedët, psikologët dhe punonjësit socialë për të siguruar ndërhyrje të përshtatshme dhe në kohë. Studimet tregojnë se bashkëpunimi ndërdisiplinor, si partneritetet mes mësuesve dhe terapistëve apo përfshirja aktive e prindërve në terapi, përmirëson ndjeshëm rezultatet. Megjithatë, mungesa e qartësisë së roleve dhe komunikimi i dobët e dëmtojnë këtë efektivitet. Modelet ndërkombëtare nga Brazili, India, Malawi, Indonezia dhe SHBA-ja dëshmojnë se koordinimi ndërsektorial, planifikimi i përbashkët dhe vrojtimet rutinë ndikojnë pozitivisht në ecurinë zhvillimore të fëmijëve. Këto shembuj praktikë konfirmojnë se ndërtimi i një rrjeti gjithëpërfshirës bashkëpunues – ku prindërit, mësuesit dhe profesionistët e shëndetit veprojnë në harmoni – është një strategji e realizueshme dhe efektive për të mbështetur zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

Kapaciteti i mentalizimit dhe përshtatja psikologjike tek individët me përvoja traumatike

PhD. Cand. Arjeta Ahmed Seferi

Mentalizimi, i njohur si aftësia për të kuptuar dhe interpretuar sjelljet e vetes dhe të tjerëve nëpërmjet referimit ndaj gjendjeve të brendshme mendore, është një koncept kyç në psikologjinë zhvillimore dhe klinike. Kjo aftësi luan një rol mbrojtës të rëndësishëm në përballimin e përvojave traumatike, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien psikologjike të individit. Literatura tregon se trauma mund të cenojë funksionimin e mentalizimit, duke e bërë të vështirë për individët të kuptojnë ndjenjat, mendimet dhe motivimet e tyre, si dhe të tjerëve. Si rezultat, individët me përvoja traumatike shpesh përballen me vështirësi të përshtatjes psikologjike, të manifestuara përmes simptomave të ankthit, depresionit dhe çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD). Kapaciteti i ruajtur ose i zhvilluar i mentalizimit ndihmon në reduktimin e simptomave të tilla, duke mundësuar një përpunim më të shëndetshëm të traumës dhe duke promovuar reziliencën emocionale. Në këtë kuptim, mentalizimi përbën një faktor mbrojtës dhe një objektiv të rëndësishëm për ndërhyrjet psikoterapeutike tek individët e ekspozuar ndaj traumave. Fjalë kyçe: kapaciteti i mentalizimit, trauma, PTSD, depresion, ankth

Inovacionet në Terapinë e Implantit Cochlear: Studim Rasti mbi Strategjitë për Përmbushjen e Nevojave të Fëmijëve me Humbje Dëgjimi

Bsc. Albina Statovci & Bsc. Fjolla Rexha

Implantet cochleare përfaqësojnë një nga zhvillimet më të rëndësishme në trajtimin e humbjes së thellë të dëgjimit, veçanërisht tek fëmijët, duke u mundësuar atyre akses në botën e tingujve dhe mundësinë për zhvillimin e gjuhës së folur (Nicholas & Geers, 2013). Megjithëse përparimet teknologjike në dizajnin dhe funksionimin e këtyre pajisjeve janë të konsiderueshme, suksesi i procesit rehabilitues varet në masë të madhe nga ndërhyrja e hershme dhe e strukturuar logopedike. Roli i logopedit është thelbësor në mbështetjen e fëmijës për të ndërtuar dëgjimin funksional, për të përvetësuar gjuhën dhe për të zhvilluar aftësi efektive të komunikimit (Dettman et al., 2016).

Ky punim shqyrton qasjet terapeutike bashkëkohore pas implantimit cochlear, të mbështetura në prova shkencore dhe të përshtatura sipas nevojave individuale të fëmijës. Fokus i veçantë i studimit është trajnimi auditiv, përdorimi i ndërhyrjeve të drejtuara për ndërtimin e gjuhës, integrimi i gjuhës në aktivitetet e përditshme, si dhe përfshirja aktive e prindërve në procesin terapeutik. Po ashtu, theksohet rëndësia e bashkëpunimit ndërdisiplinor me profesionistë të tjerë për të siguruar një ndërhyrje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për secilin fëmijë. Qëllimi i këtij prezantimi është të ofrojë një pasqyrë praktike dhe teorike të strategjive më efektive për mbështetjen e zhvillimit të të folurit tek fëmijët me implant cochlear, duke u bazuar në evidence shkencore dhe praktikë profesionale dhe gjithashtu duke e vendosur logopedin si një hallkë kyçe në procesin e integrit të suksesshëm të fëmijës në jetën sociale dhe arsimore.

Fjalë kyçe: implant cochlear, komunikimi, humbje e dëgjimit, trajtimi logopedik.

Ndikimi i Pajisjeve Teknologjike në Aftësite e Lëvizjes së Gishtave dhe Artikulimit: Ndërlidhja në mes Këtyre Dy Aftësive

Bsc. Yllka Imeri

Me rritjen e fundit të popullaritetit të pajisjeve teknologjike, përdorimi i tyre është bërë pjesë e pandashme e jetës së përditshme dhe tani shihet si pjesë integrale për të gjitha grupmoshat, përfshirë edhe fëmijët e moshës parashkollore. Ndërkohë që këto pajisje ofrojnë mundësi të reja për mësim dhe ndërveprim social, njëkohësisht ato po zëvendësojnë gradualisht aktivitetet që përfshijnë lëvizjet e motorikës fine veçanërisht, ato që përfshijnë përdorimin aktiv të gishtërinjve – të cilat janë thelbësore për zhvillimin motorik dhe të të folurit. Studime të mëparshme kanë dëshmuar një lidhje të ngushtë ndërmjet aftësive të lëvizjes së gishtërinjve dhe zhvillimit të aftësive të artikulimit tek fëmijët. Nisur nga kjo, ky studim ka për qëllim të shqyrtojë ndikimin e përdorimit të pajisjeve teknologjike në zhvillimin e aftësive të lëvizjes së gishtërinjve dhe të eksplorojë ndërlidhjen mes këtyre aftësive dhe artikulimit të të folurit tek fëmijët. Mostra e përzgjedhur për këtë hulumtim përfshiu 50 fëmijë të moshës pesë vjeç, të cilët frekuentojnë institucione parashkollore në qytetin e Prishtinës. Është aplikuar qasja kuantitative, duke përdorur dy instrumente për vlerësimin e aftësive të artikulimit dhe të aftësive së lëvizjes së gishtërinjve. Rezultatet e studimit treguan se njëra nga tri hipotezat e ngritura është aprovuar dhe është me rëndësi statistikore ($p < 0.05$), duke sugjeruar ekzistencën e një ndërlidhjeje të konsiderueshme midis përdorimit të pajisjeve teknologjike, koordinimit të lëvizjeve të gishtërinjve dhe aftësive të artikulimit të tingujve. Ky studim thekson rëndësinë e një qasjeje të balancuar ndaj përdorimit të pajisjeve teknologjike në fëmijërinë e hershme. Aktivitetet që stimulojnë aftësitë motorike fine janë thelbësore për zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe motorike të fëmijëve. Prandaj, rekomandohet që edukatorët dhe prindërit të ndërmarrin masa të vetëdijshe për të integruar aktivitete stimuluese në rutinën ditore të fëmijëve, duke siguruar një zhvillim të shëndetshëm dhe gjithëpërfshirës.

Fjalë kyçe: zhvillimi motorik, teknologjia, artikulimi, fëmijët pesëvjeçarë

Qeliza të Vogla me Përgjigje të Mëdha: Modelet iPSC dhe e Ardhmja e Kërkimeve mbi Autizmin

Msc. Erestinë Uka

Me rritjen e vazhdueshme të numrit të fëmijëve të diagnostikuar me çrregullim të spektrit të autizmit (ASD) dhe sfidat në identifikimin e etiologjisë së tij, qelizat bazë shumëpotenciale të induktuara (iPSC) ofrojnë një mundësi të re premtuese në kërkimin shkencor. Këto qeliza, të cilat krijohen përmes riprogramimit të qelizave të diferencuara somatike në një gjendje pluripotente, mund të diferencohen në tipe të ndryshme qelizash nervore, duke ofruar një platformë të fuqishme për modelimin e çrregullimeve neurozhvillimore në nivel qelizor dhe molekular. Ky prezantim paraqet një rishikim narrativ të 13 studimeve kryesore që përdorin modele qelizore iPSC për të kuptuar më mirë mekanizmat biologjikë të autizmit. Gjetjet kryesore përfshijnë zhvillim të vonuar të neuroneve, çekuilibër ndërmjet sinapseve eksituese dhe inhibitore, si dhe çrregullime në shprehjen e gjeneve – ku të gjitha këto kontribuojnë në fenotipin kompleks të autizmit. Modelet iPSC kanë potencial për të lidhur kërkimin laboratorik me ndërhyrje klinike të personalizuar, duke hapur rrugë të reja për përmirësimin e mirëqenies dhe mbështetjes individuale tek fëmijët me ASD.

Fjalë kyçe: Autizmi, Neurozhvillimi, iPSC, Neurodiversitetjeçarë

Incidenca e Kancerit në Kosovë: Një Analizë e të Dhënave nga Instituti i Onkologjisë

Prof. As. Dr. Ilir Kurtishi

Ky studim shqyrton trendet e incidencës së kancerit në Kosovë gjatë një periudhe pesëvjeçare (2019–2023) duke përdorur të dhëna nga Instituti i Onkologjisë në Qendrën Spitalore Universitare të Kosovës - qendra e vetme onkologjike në vend. Pavarësisht se Kosova ka shkallët më të ulëta të incidencës së kancerit të standardizuara sipas moshës midis vendeve të Ballkanit, rritjet e fundit ngrenë shqetësime në lidhje me nën-raportimin për shkak të mungesës së programeve kombëtare të shqyrtimit dhe strukturës së popullsisë së re të vendit. Studimi analizon shkallët e incidencës të standardizuara sipas moshës, shpërndarjen e kancerit sipas kodeve ICD-10 dhe grupmoshave, dhe efektet e pandemisë COVID-19 në zbulimin e rasteve.

Gjetjet zbulojnë një rënie të dukshme të rasteve të reja gjatë izolimit të vitit 2020 (-16%), e ndjekur nga një rritje pas pandemisë, me shkallët e incidencës që u rritën nga 98.77 (2019) në 142.7 (2023). Kanceret më të zakonshme ishin tumoret e gjirit dhe gastrointestinale (GI), me 28% të tumoreve GI të diagnostikuara në faza metastatike, duke ndikuar ndjeshëm në kërkesat për trajtim. Grupmosha 60-69 vjeç tregoi vazhdimisht incidencën më të lartë gjatë të gjitha viteve.

Analiza nxjerr në pah një barrë kanceri në rritje të shpejtë në Kosovë, duke theksuar nevojën urgjente për programe kombëtare të shqyrtimit të kancerit, sisteme të përmirësuara të raportimit të të dhënave dhe politika më të gjera parandaluese. Pa ndërhyrje sistemike, tendenca në rritje mund të sforcojë burimet e kufizuara të onkologjisë. Studimi mbështet strategjitë e kontrollit të kancerit të bazuara në prova dhe bashkëpunimin ndërsektorial për të përmirësuar rezultatet e shëndetit publik në Kosovë.

Fjalë kyçe: incidenca e kancerit, Kosova, normat e standardizuara sipas moshës, onkologjia, programet e shqyrtimit, tumoret gastrointestinale, kanceri i gjirit

Roli dhe Përgjegjësitë e Familjeve në Fazat e Diagnozës, Vlerësimit dhe Monitorimit të Individëve me Çrregullim të Spektrit Autizmit

Prof. As. Dr. Fatih Koçak

Procesi i diagnostikimit, vlerësimit dhe monitorimit të çrregullimit të spektrit të autizmit (ÇSA) përbën një ekosistem kompleks që përfshin vëzhgime të hershme, informacion klinik dhe bashkëpunim familjar në ndërhyrje dhe vendimmarrje. Ky ekosistem vendos klinikistët, edukatorët dhe politikëbërësit përballë sfidës për të zhvilluar një kornizë të përbashkët, pasi ende ekzistojnë pasiguri të konsiderueshme metodologjike në literaturë sa i përket institucionalizimit të përfshirjes së familjes. Përveç analizimit gjithëpërfshirës të rezultateve që lidhen me efektivitetin e strategjive të përqendruara në familje, ky studim harton në mënyrë metodike rolet dhe përgjegjësitë e familjeve në fazat e: (1) diagnozës, (2) vlerësimit edukativ-klinik dhe (3) monitorimit afatgjatë. Duke përdorur analizën e përmbajtjes, studimi krahason udhëzimet ekzistuese, rregulloret ligjore dhe kërkimin empirik, duke u fokusuar në kritere si: aftësitë për jetesë të pavarur, cilësia e jetës familjare, vazhdimësia e ndërhyrjes dhe saktësia diagnostikuese. (1) Katalizator i Diagnostikimit të Hershëm: Raportimi i hershëm nga familjet për anomalitë zhvillimore ndihmon në përshpejtimin e konsultave me specialistët dhe ul rrezikun e diagnozave të pasakta. (2) Bashkëpunimi në Vlerësimin Arsimor: Përfshirja e kontekstit shtëpiak përmes bashkëpunimit familje-mësues përmirëson efektivitetin e përgatitjes së Programit të Arsimit Individual (PEI). (3) Reagime Dypalëshe në Monitorim: Qëndrueshmëria e përfitimeve socio-linguistike përmirësohet përmes ndarjes së të dhënave mes mësuesve dhe familjeve, si dhe ushtrimeve përforcuese në shtëpi. (4) Përfitimet e Programeve të Përqendruara në Familje: Edukimi familjar ndihmon në zhvillimin e aftësive të komunikimit, empatisë dhe vetërregullimit të fëmijës, si dhe në rritjen e vetëefikasitetit dhe kënaqësisë së prindërve me jetën. (5) Procedurat "Çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet bërë": Vonesat në diagnostikim, komunikim abstrakt dhe mbrojtja e tepruar çojnë në rezultate negative, ndërsa ndërhyrja e hershme promovon rezultate pozitive dhe mbron të drejtat ligjore, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për mësimdhënie në shtëpi.

Si përfundim, ky studim propozon një kornizë gjithëpërfshirëse të bazuar në idenë e "përfshirjes së hershme, intensive dhe të vazhdueshme të familjes" për të përmirësuar rezultatet zhvillimore të fëmijëve me ÇSA dhe për të promovuar qëndrueshmërinë e mirëqenies familjare. Në këtë kontekst, theksohet se praktikat klinike dhe politikat arsimore duhet të institucionalizojnë modele që e shndërrojnë familjen nga një burim pasiv informacioni në një partner aktiv në vendimmarrje gjatë gjithë procesit, nga diagnoza deri te monitorimi.

Fjalë kyçe: ÇSA, diagnozë, vlerësim, monitorim, roli i familjes.

Matja e Njohurive Mediale të Lajmeve në Shkolla të Mesme në Kosovë

Msc. Blerta Dibrani, Muhamet Jahiri. Gëzim Qerimi

Në epokën bashkëkohore, aftësia për të naviguar në media shquhet si një aftësi thelbësore. Duke njohur rëndësinë e njohurive mediatike në nxitjen e qytetarisë së informuar, ky hulumtim thellohet në konsumin kritik të informacionit në media. Pika kryesore e këtij studimi është të krahasojë njohuritë mediatike të nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve të universitetit. Për të matur njohuritë mediatike, ky hulumtim zbatoi Qasjen Shumëdimensionale për Matjen e Njohurive Mediatike. Për të eksploruar ndikimin e edukimit mbi njohuritë mediatike, të dhënat do të mblidhen përmes një ankete të shpërndarë në dy grupe të ndryshme: nxënës të shkollave të mesme pa ekspozim paraprak ndaj kurseve të njohurive mediatike dhe studentë universitarë që kanë ndjekur kursin e njohurive mediatike si pjesë të kurrikulës së tyre. Efektiviteti i edukimit mbi njohuritë mediatike do të vlerësohet në kontekstin e një vendi në tranzicion, siç është Kosova.

Fjalë kyçe: Njohuri mediatike, media të reja, nxënës të shkollave të mesme, konsum informacioni

Roli i ekzaminimeve mjekoligjore në rastet e dhunës në familje, me fokus të veçantë te fëmijët

Dr. Naim Uka

Dhuna në familje mbetet një nga sfidat më të mëdha të shëndetit publik dhe të drejtësisë sociale, duke ndikuar veçanërisht fëmijët, të cilët shpesh janë viktimë të drejtpërdrejta ose dëshmitarë të traumave të rënda. Ky prezantim synon të trajtojë rolin vendimtar që luajnë ekzaminimet mjekoligjore në identifikimin, dokumentimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje ndaj fëmijëve.

Përmes një qasjeje multidisiplinare që përfshin mjekësinë ligjore, psikologjinë dhe të drejtën penale, studimi analizon mënyrat në të cilat ekzaminimet fizike dhe psikosociale kontribuojnë në mbledhjen e provave të besueshme për të vërtetuar rastet e abuzimit. Vëmendje e veçantë i kushtohet sfidave të ekzaminimit të fëmijëve, duke përfshirë nevojën për teknikë të ndjeshme dhe të përshtatur për moshën, si dhe për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të tyre gjatë procesit hetimor. Përmes analizës së rasteve dhe praktikave mjekoligjore, theksohet rëndësia e bashkëpunimit ndërinstytucional midis institucioneve shëndetësore, policisë, prokurorisë dhe shërbimeve sociale për të garantuar ndërhyrje efektive dhe mbrojtje të menjëhershme për fëmijët. Në përfundim, prezantimi ofron rekomandime për forcimin e kapaciteteve të profesionistëve dhe standardizimin e protokolleve të ekzaminimeve mjekoligjore në rastet e dhunës në familje me viktimë fëmijë.

Fjalë kyçe: Dhuna në familje, fëmijët, ekzaminime mjekoligjore, abuzimi, të drejtat e fëmijëve, multidisiplinariteti

Ndikimi i kontekstit familjar në zhvillimin e fëmijës: Midis përvojës klinike dhe kërkimit shkencor

PhD. Cand. Lirie Lokaj Mazreku

Dinamika në familje padyshim ndikon në të gjitha aspektet e zhvillimit të fëmijës. Nga përvoja klinike vihet re se fëmijët preken drejtpërdrejt nga marrëdhëniet dhe mjedisi brenda familjes, jo vetëm në mirëqenien emocionale, por edhe në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.

Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat nga studimi i realizuar me 350 mësimdhënës të ciklit të mesëm të ulët në Kosovë, ku u eksplorua edhe ndikimi i faktorëve familjarë dhe kulturorë në zgjedhjen e profesionit të mësimdhënies. Rreth 52% e pjesëmarrësve raportuan se kanë pasur një anëtar të afërt të familjes në profesionin e mësimdhënësit, shpesh si frymëzim që nga fëmijëria. Ndikimi më i lartë vërehet nga babai (15.4%), i pasuar nga motra (9.1%), nëna (8%), vëllai (6.6%), gjyshi/gjyshja (4%), dhe figura të tjera familjare (8.9%). Këto gjetje theksojnë ndikimin e fuqishëm të kontekstit familjar dhe kulturor në zhvillimin profesional të individit, duke sugjeruar se përvojat e hershme dhe modelet familjare luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e zgjedhjeve të karrierës dhe në mënyrën se si të rriturit ndërtojnë marrëdhënie dhe i qasen nevojave emocionale të fëmijëve.

Në këtë kontekst, koncepti "duhet një fshat për të rritur një fëmijë" nuk është vetëm një metaforë, por një realitet që kërkon ndërlidhje të qëndrueshme ndërmjet familjes, shkollës dhe komunitetit. Vetëm përmes një rrjeti të tillë mbështetës mund të sigurohet që fëmijët të ndihen të dëgjuar, të sigurt dhe të fuqizuar.

Ky prezantim synon të hedhë dritë mbi ndërlidhjen midis përvojës klinike me të rritur dhe të dhënave të kërkimit shkencor, me qëllim fuqizimin e zërit të fëmijëve si pjesëmarrës të rëndësishëm në jetën familjare dhe zhvillimin e tyre të gjithanshëm.

Fjalët kyçe: Dinamika familjare, zhvillimi i fëmijës, profesioni i mësimdhënies, ndikimi kulturor

Shqyrtimi Kritik i Lektyrave Shkollore

Prof. As. Dr. Urela Demaj & Agon Ahmeti

Ky punim paraqet gjetjet e një studimi kërkimor të ETEA-s mbi gjuhën dhe strukturat diskursive të teksteve letrare të rekomanduara në arsimin e mesëm të ulët në Kosovë. Duke u mbështetur në Analizën Kritike të Diskursit (AKD), studimi shqyrton dhjetë lista të teksteve letrare të rekomanduara në shkolla dhe një korpus të përzgjedhur prej njëmbëdhjetë veprave letrare që u caktohen shpesh nxënësve në klasat 6 deri në 9. Analiza nxjerr në pah një mbështetje sistematike në një katalog të teksteve letrare të shkruara para viteve 1990, me mungesë të shkrimtareve gra dhe letërsisë bashkëkohore që pasqyron realitetet pasluftës apo zhvillimet socio-kulturore. Përtej mospërputhjes kohore, tekstet shfaqin modele gjuhësore të përsëritura, përjashtuese dhe të papërshtatshme në aspektin etik, përfshirë diskurs diskriminues – veçanërisht ndaj komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian – seksualizim të të miturve, estetizim të traumës dhe dhunës, si dhe stereotipe gjinore që kufizojnë rolet e grave. Gjetjet tregojnë mungesën e kornizimit kritik pedagogjik, ku intervistat gjysmë të strukturuar me mësimdhënës dhe nxënës konfirmojnë se konteksti shoqëror-kulturor dhe historik i teksteve rrallëherë bëhet i qasshëm, duke i lënë nxënësit të përvetësojnë materiale komplekse pa udhëzim interpretues. Studimi argumenton se një ekspozim i tillë i pafiltruar mund të jetë problematik – veçanërisht për lexuesit e rinj që ende janë në proces të zhvillimit të gjykitimit kritik dhe ndjeshmërisë qytetare. Si përgjigje, ETEA bën thirrje për zhvillimin institucional të kriterëve për përzgjedhjen e teksteve letrare, të bazuara në gjuhë të përshtatshme për moshën dhe angazhim të mësimdhënësve për qasje kritike në klasë.

Fjalë kyçe: përdorimi i gjuhës, Analiza Kritike e Diskursit (AKD), tekste letrare, kultura e leximit, Kosova

E drejta e grave të vetme në IVF: perspektiva e fëmijut mbi të drejtën për ta njohur të atin

Dr. Sc. Doruntinë Demiri

Një nga debatet më të nxehta që ka lënë prapa pothuajse të gjitha debatet për nismat legislative në Republikën e Kosovës është ai mbi projektligjin për shëndetin riprodhues. Pikë kyce që ka përplasur qëndrimet radikale dhe që ka penguar hyrjen në fuqi të këtij projektligji është edhe njohja e të drejtës për të shfrytëzuar shërbimet e fertilizimit të asistuar mjekësor nga gratë e vetme. Argumentet që kanë domuniar gjuhën e kundërshtarëve të zëshëm të kësaj të drejte janë: e drejta e fëmijës për të njohur babain si dhe ndikimi negativ i mungesës së figurës së babait gjatë rritjes. E afirmuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Mikulić kundër Kroacisë në vitin 2002, e drejta e fëmijës për të njohur babain është një aspekt fundamental i identitetit personal dhe jetës familjare. Ky përcaktim historik i gjykatës vendosë detyrim pozitiv për shtetet nënshkruese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që të sigurojnë mekanizma ligjorë efektiv që fëmijët të mund të zbulojnë identitetin e babait të tyre biologjik duke qenë se një gjë e tillë është thelbësore për jetën private dhe mirëqenien psikologjike të fëmijës. Sidoqoftë, kjo e drejtë duhet barazpeshuar kundrejt ndryshimit të strukturës së familjes dhe teknologjisë së riprodhimit. Ky studim argumenton se fëmijëve duhet t'u njihet e drejta për tu informuar për identitetin e babait biologjik, megjithatë, ky parim nuk duhet t'ia mohoj gruas së vetme të drejtën për të lindur fëmijë nëpërmjet fertilizimit të asistuar mjekësor. Në vend të bllokimit të projektligjit, ligjvënësit duhet të dizajnojnë një model që mundëson identifikimin e babait biologjik nën kushte të caktuara.

Sfidat e bashkëpunimit me prindër gjatë intervenimit të hershëm

Ma. Lira Baliu

Bashkëpunimi midis prindërve dhe profesionistëve të fushës së ndërhyrjes së hershme është një komponent kyç për suksesin e ndërhyrjeve dhe përparimin e zhvillimit të fëmijëve gjatë viteve të para të jetës. Studimet tregojnë se marrëdhëniet pozitive dhe të qëndrueshme ndërmjet familjeve dhe profesionistëve përmirësojnë ndjeshëm rezultatet zhvillimore të fëmijët (Blue-Banning et al., 2004). Objektivat e këtij hulumtimi janë të identifikojnë sfidat kryesore që hasin terapistët gjatë bashkëpunimit me prindërit dhe të eksplorojnë faktorët që ndikojnë në cilësinë e këtij bashkëpunimi, si dhe të ofrojnë strategji për të përmirësuar marrëdhënien dhe bashkëpunimin me prindërit. Ky punim përbën një studim kuantitativ, pasi të dhënat për realizimin e hulumtimit janë mbledhur përmes anketave ose pyetësorëve. Studimi është gjithashtu ndër-sektorial, pasi të dhënat janë mbledhur një herë, brenda një periudhe të caktuar kohore. Në përputhje me qëllimin e tij, ky studim ka karakter shpjegues, duke analizuar faktorët që ndikojnë në marrëdhënien prind-terapist. Për këtë hulumtim është përdorur një mostër heterogjene, e cila përfshin gjithsej 58 pjesëmarrës. Nga ta, 55 ishin të gjinisë femërore dhe 3 të gjinisë mashkullore. Moshë e pjesëmarrësve varionte nga 21 deri në 54 vjeç, me një moshë mesatare prej 28 vjetësh. Sa i përket profesionit, 24 pjesëmarrës ishin psikologë dhe terapistë të sjelljes, 20 ishin logopedë, 10 edukatorë dhe 4 të tjerë ishin terapistë të fushave të ndryshme.

Përvoja e tyre profesionale varionte nga 6 muaj deri në 18 vite, me një përvojë mesatare prej 4 vitesh. Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur anketimi si instrument matës. Pyetjet ishin të njëjta për të gjithë, për arsye të lehtësimit të konkludimeve dhe rezultateve, si dhe eliminimit të limitimeve të ndryshme që mund të ndodhin si shkak i pyetjeve të ndryshme. Anketa e formuar ka kaluar përmes validitetit të përmbajtjes dhe validitetit konstruktiv. Sipas të dhënave të mbledhura nga raportimet e terapistëve të përfshirë në fushën e ndërhyrjes së hershme, sfida kryesore në bashkëpunim me prindërit lidhet me pritshmëritë joreale që ata kanë ndaj progresit të fëmijës. Po ashtu, një pengesë e rëndësishme identifikohet edhe në nivelin e ulët të angazhimit të prindërve në procesin terapeutik, si dhe në mbingarkesën e tyre me këshilla kontradiktore, shpesh të ndikuara nga burime jo-profesionale ose keqinformime në platforma online. Ndër faktorët e tjerë që ndikojnë negativisht në cilësinë e bashkëpunimit përfshihen gjendja emocionale e prindërve, niveli i besimit dhe marrëdhënia me terapistin, faktorët socio-ekonomikë, si dhe dallimet kulturore dhe gjuhësore. Megjithatë, në përballje me këto sfida, si nga përvoja e terapistëve ashtu edhe nga literatura shkencore, janë identifikuar disa strategji kyçe për ndërtimin e një bashkëpunimi efektiv me prindërit. Ndër to përfshihen: komunikimi i hapur, ndërtimi i respektit dhe besimit të ndërsjellë, organizimi i takimeve të rregullta, përkushtimi ndaj procesit terapeutik dhe përcaktimi i qartë i roleve të secilës palë (Marshall & Mirenda, 2002).

Fjalë kyçe: Sfidat, bashkëpunimi, intervenimi i hershëm, prind, terapist

Asociacioni dykahësh i faktorëve familjarë dhe mirëqenies psikologjike të fëmijët dhe adoleshentët me aftësi të kufizuara në Kosovë.

PhD. Cand. Ilirjana Geci

Ky studim shqyrtoi asociacionin dykahësh midis faktorëve familjarë dhe mirëqenies psikologjike të fëmijët dhe adoleshentët me aftësi të kufizuara nga një perspektivë kualitative. Studimi përqendrohet në kuptimin e dinamikave dykahëshe midis mirëqenies psikologjike të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe marrëdhënieve të tyre të rëndësishme sociale, me fokus të veçantë të prindërit dhe motrat/vëllezërit. Nëpërmjet intervistave të gjysmë strukturuar me 7 fëmijë me aftësi të kufizuara, 7 prindër dhe 7 vëllezër/motra, studimi hulumton se si mirëqenia e fëmijëve dhe adoleshentëve me aftësi të kufizuara ndikon dhe ndikohet nga dinamika brenda njësisë familjare.

Të gjeturat treguan se “aftësia e kufizuar” ka një ndikim njëkahësh në faktorët familjarë, duke formësuar ndërveprimet me prindërit dhe motrat/vëllezërit, si dhe duke ndikuar drejtpërdrejt mirëqenien psikologjike të fëmijës. Në anën tjetër, faktorët familjarë treguan një marrëdhënie dykahëshe me mirëqenien e fëmijës, duke ndikuar dhe u ndikuar në mënyrë të ndërsjellë. Gjetjet treguan një sinkroni emocionale midis mirëqenies së fëmijëve dhe prindërve të tyre dhe anasjelltas, duke nxjerrë në pah vetëdijën e ndërsjellë emocionale, por edhe sfida që lidhen me mbimbrotjen dhe mungesën e autonomisë. Marrëdhëniet me motrat dhe vëllezërit karakterizoheshin nga besimi, mbështetja e ndërsjellë dhe lidhja emocionale, megjithatë disa prej tyre shprehën ndjenja të anashkalimit për shkak të vëmendjes së prindërve dhe vënies së lumturisë së motrës/vëllait me aftësi të kufizuara mbi nevojat e tyre personale.

Me rëndësi të veçantë, ky studim thekson se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë thjesht marrës pasivë të kujdesit, por agjentë aktivë që formësojnë dhe ndikojnë mjedisin në të cilin jetojnë. Mirëqenia e tyre psikologjike ndikon dhe ndikohet nga klima emocionale dhe dinamika relacionale brenda familjes. Për më tepër, përvoja e të qenit prind apo motër/vëlla i një fëmije me aftësi të kufizuara përfshin sfida dhe procese emocionale që dallojnë dukshëm nga ato në familjet pa prani të aftësisë së kufizuar.

Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e mbështetjes së të gjithë familjes, duke njohur se prindërit dhe motrat/vëllezërit e fuqizuar dhe të mbështetur janë në gjendje të krijojnë një mjedis kujdesës dhe të përgjegjshëm që promovon zhvillimin, autonominë dhe mirëqenien e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Fjalë Kyçe: Aftësi e kufizuara, Asociacioni dykahësh, Mirëqenia psikologjike, Faktorët familjarë.

Funksionet Ekzekutive tek Individët me Autizëm

Prof. As. Dr. Ahmet Hocaoglu

Funksionet ekzekutive (FEK) janë procese njohëse të nivelit të lartë, të tilla si inhibimi, kujtesa e punës dhe fleksibiliteti njohës - thelbësore për sjelljen e drejtuar nga qëllimi. Këto funksione ndërmjetësohen kryesisht nga korteksi prefrontal dhe luajnë një rol kritik në performancën akademike, rregullimin emocional dhe funksionimin adaptiv. Hulumtimet kanë treguar vazhdimisht se individët me çrregullim të spektrit të autizmit (ÇSA) shfaqin deficite në fushat kryesore të FEK-së, megjithëse natyra dhe ashpërsia e këtyre dëmtimeve mund të ndryshojnë në varësi të zhvillimit dhe kërkesave të detyrave.

Ky rishikim synon të sintetizojë gjetjet aktuale mbi FEK-në tek individët me ÇSA, duke u përqendruar në komponentët kryesorë, ndryshimet që lidhen me moshën dhe qasjet e ndërhyrjes. Gjetjet tregojnë se individët me ÇSA shpesh përjetojnë sfida në kujtesën e punës, veçanërisht në detyrat vizuo-spatiale; vështirësi me kontrollin inhibues; dhe fleksibilitet të kufizuar njohës. Këto dëmtime shoqërohen me kufizime funksionale si në fëmijëri ashtu edhe në moshë madhore.

Dallimet specifike në moshë nxjerrin në pah nevojën për zbulim të hershëm, pasi fëmijët e moshës parashkollore me deficite të FEK-së shpesh shfaqin vështirësi më të theksuara të sjelljes dhe sociale. Ndërsa, disa të rritur me ÇSA mund të performojnë në mënyrë të ngjashme me bashkëmoshatarët me zhvillim tipik në mjedise të strukturuar, sfidat e tyre themelore në FEK-së mbeten. Strategjitë e ndërhyrjes, duke përfshirë programet e trajnimit të sjelljes dhe njohjes, kanë treguar potencial për përmirësimin e këtyre aftësive tek fëmijët me ÇSA. Megjithatë, qëndrueshmëria e këtyre përfitimeve dhe përgjithësimi i tyre në fusha më të gjera të jetës mbeten të kufizuara.

Si përfundim, ndërsa deficitet e EF-së janë një tipar i qëndrueshëm i ÇSA-së, hulumtimet e reja mbështesin efikasitetin e ndërhyrjeve të synuara. Nevojiten kërkime të vazhdueshme për të rafinuar këto qasje dhe për t'i përshtatur ato me profile individuale të zhvillimit.

Fjalë kyçe: funksione ekzekutive, çrregullim i spektrit të autizmit, kujtesë pune, fleksibilitet njohës, strategji ndërhyrjeje

Vlerësimi i Ndikimit të Trajnimit për Inteligjencën Emocionale në Efektivitetin e Mësimdhënësve: Një Studim Krahases Para-Pas

Phd. Cand. Dorentina Murturi

Ky studim vlerësoi ndikimin e një programi të strukturuar të trajnimit për Inteligjencën Emocionale (IE) në kompetencat emocionale të mësimdhënësve dhe efektivitetin e tyre në këtë proces. Duke përdorur dizajnin para-dhe pas-testimit, 100 mësimdhënës të përzgjedhur me mostrim të qëllimshëm, plotësuan Testin e Vetë-raportimit për Inteligjencën Emocionale (SSEIT) dhe Shkallën e Ndjesisë së Efikasitetit të Mësuesimdhënësve (TSES) përpara dhe pas pjesëmarrjes së tyre në Manualin e Trajnimit për Inteligjencën Emocionale të McPheat (2010). Rezultatet nga testi-t treguan përmirësim domethënës në nivelin e përgjithshëm të Inteligjencës Emocionale (para testimit: $M = 126.85$, $SD = 14.42$; pas testimit: $M = 139.63$, $SD = 12.85$; $t(99) = 13.77$, $p < .001$, d i Cohen = 1.28) dhe në Efektivitetin e Mësimdhënies (para testimit: $M = 7.12$, $SD = 0.74$; pas testimit: $M = 8.75$, $SD = 0.65$; $t(99) = 9.85$, $p < .001$, d i Cohen = 0.98), Rezultatet nga dimensionet e Inteligjencës Emocionale, gjeten po ashtu përmirësime të dukshme në të gjitha kompetencat emocionale, veçanërisht në Vetëdijshmërinë Emocionale, Kontrollin Emocional dhe Rregullimin Emocional (d i Cohen > 1.09). Rezultatet treguan gjithashtu përmirësime të mëdha edhe në nënshkallët e efektivitetit të mësimdhënësve, përfshirë këtu: strategjitë mësimore, menaxhimin e klasës dhe angazhimin e nxënësve. Këto rezultate u mbështetën edhe nga intervista cilësore të realizuara me një nëngrup prej 20 mësimdhënësve. Të dhënat cilësore pas trajnimit treguan rritje të vetërregullimit emocional, empatisë, menaxhimit të konflikteve, qëndrueshmërisë dhe klimës së klasës. Mësimdhënësit poashtu përmendën një rikonceptim të vetvetes në lidhje me profesionin e tyre, duke përfshirë inteligjencën emocionale si një aspekt thelbësor për një mësimdhënie efektive. Në tërësi, këto rezultate konfirmuan se trajnimi i strukturuar për Inteligjencën Emocionale, përmirëson ndjeshëm si kompetencat emocionale, ashtu edhe ato instruktive të mësimdhënësve, duke sugjeruar implikime të rëndësishme për programet e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

Fjalë kyçe: Inteligjenca emocionale, efektiviteti i mësimdhënësve, kompetencat emocionale, edukimi emocional, trajnimi i mësimdhënësve.

Konceptualizimi i lumturisë te të rinjtë në Kosovë: Gjetje preliminare nga një studim eksplorues

**Prof. Asoc. Dr. Dashamir Bërxulli, Prof. Asoc. Dr. Kaltrina Kelmendi, dhe
As. Dr. Natyra Agani Destani**

Hulumtimet ekzistuese tregojnë, se ndonëse fëmijët dhe adoleshentët në përgjithësi raportojnë nivele të larta të kënaqësisë me jetën dhe lumturisë, ekzistojnë dallime të mëdha mes dhe brenda vendeve (Taylor et al., 2022). Pjesa më e madhe e provave vjen nga vendet e zhvilluara dhe të industrializuara perëndimore (të njohura si WEIRD: Western, Educated, Industrialized, Rich, and Developed), duke lënë një boshllëk të rëndësishëm në literaturën, që vjen nga vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Në këtë kontekst, ky studim synon të eksplorojë lumturinë dhe mirëqenien te fëmijët dhe adoleshentët në Kosovë dhe Shqipëri, duke ofruar një kuptim më të gjerë dhe më të ndjeshëm ndaj kontekstit social dhe kulturor të këtyre vendeve.

Ky studim eksplorues synon të kuptojë mënyrën se si fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë në Kosovë konceptualizojnë lumturinë, në kontekstin e zhvillimit të tyre social, kulturor dhe psikologjik. Duke u mbështetur në kornizën ekologjike të zhvillimit, hulumtimi shqyrton faktorët individualë, familjarë dhe komunitarë, që ndikojnë në përjetimin dhe kuptimin e lumturisë ndërmjet grupmoshave të ndryshme.

Studimi përdor një dizajn të kombinuar kërkimor (kualitativ dhe kuantitativ), i administruar tek 150 pjesëmarrës të moshës 8–18 vjeç në Kosovë. Të dhënat preliminare janë mbledhur kryesisht përmes intervistave gjysmë-strukturuara me fëmijë dhe të rinj. Gjetjet fillestare sugjerojnë, se lumturia perceptohet si një gjendje, që buron nga mbështetja familjare, marrëdhëniet pozitive me bashkëmoshatarët, ndjenja e sigurisë emocionale dhe mundësitë për vetë-shprehje dhe pjesëmarrje aktive. Në veçanti, pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e ndjenjës së të qenit të dëgjuar dhe të vlerësuar në shkollë dhe në komunitet.

Ky studim kontribuon në literaturën mbi mirëqenien e të rinjve në kontekste të pas-konfliktit dhe ofron baza të rëndësishme për zhvillimin e politikave dhe ndërhyrjeve të ndjeshme ndaj moshës dhe kulturës që synojnë përmirësimin e mirëqenies së tyre psikologjike dhe sociale.

Fjalët kyçe: Lumturia, studimi eksplorues, fëmijët, modeli ekologjik, Kosova

Mik apo armik? Strategjitë e Integritit Social dhe Koordinimit tek Adoleshentët e Rinj

Msc. Lum Zharku

y studim shqyrton ndërveprimin ndërmjet strategjive të vendimmarrjes së adoleshentëve në kontekste konkurruese, bashkëpunuese dhe të bazuara në llotari, dhe integritit të tyre shoqëror me bashkëmoshatarët. Duke përdorur një kampion prej 177 adoleshentësh italianë, kërkimi eksploron se si sjelljet në mjedise të kontrolluara me bazë në teorinë e lojërave lidhen me nominimet e bashkëmoshatarëve në kontekste klasash. Rezultatet tregojnë se marrja e rrezikut në situata konkurruese dhe varianca e përgjigjeve lidhen në mënyrë domethënëse me një rritje të nominimeve si "më pak të pëlqyerit", duke treguar se adoleshentët që marrin më shumë rreziqe dhe që shfaqin më pak variancë në përgjigje në situata konkurruese janë më të prirur të refuzohen nga bashkëmoshatarët. Në të kundërt, marrja e rrezikut në situata bashkëpunuese nuk ishte e lidhur me integritin shoqëror. Për aq sa dimë, ky është studimi i parë që dokumenton një lidhje ndërmjet sjelljes në lojëra ekonomike dhe rezultateve ekologjike shoqërore të rëndësishme për mirëqenien e adoleshentëve, siç është integriti me bashkëmoshatarët. Këto gjetje sugjerojnë se suksesi i adoleshentëve në integritin me bashkëmoshatarët pasqyrohet pjesërisht në mënyrën se si ata përballen me probleme të thjeshtuara koordinimi me të tjerë anonimë në kushte të kontrolluara. Kjo hedh dritë mbi drejtime të reja premtuese për të studiuar bazat njohëse të integritit shoqëror gjatë adoleshencës, duke ofruar një perspektivë të re mbi mënyrën se si sjelljet konkurruese mund të formësojnë statusin shoqëror dhe marrëdhëniet me bashkëmoshatarët gjatë kësaj faze zhvillimore.

Vlerësimi i Ekipit Multidisciplinar për Trajtimin e Rasteve me Vështirësi të Gjuhës dhe Komunikimit

Bsc. Fitore Sherifi Kelmendi

Ky hulumtim synon të vlerësojë shkallën dhe cilësinë e bashkëpunimit ndërdisiplinor midis logopedëve dhe profesionistëve të tjerë të ekipit multidisciplinar në trajtimin e rasteve me çrregullime të gjuhës dhe të të folurit. Në këtë hulumtim morën pjesë 121 profesionistë nga fusha të ndryshme të shëndetit dhe edukimit. Si instrument matës është përdorur pyetësi i zhvilluar nga Luecht et al. (1990), i njohur si "IEPS: Shkalla e Përceptimit të Arsimit Ndërdisiplinor". Ky instrument është konceptuar për të vlerësuar perceptimet profesionale dhe ndërveprimin ndërdisiplinor të pjesëmarrësve në programe të edukimit të përbashkët profesional. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se për bashkëpunim profesional 72 prej personave janë përgjigjur që plotësisht pajtohen kurse 24 prej tyre se mesatarisht pajtohen. Ka dallime gjinore mes ekipit të profesionistëve shëndetësor ku është parë se 50 femra dhe 6 meshkuj punojnë me mungese të vëmendjes dhe të koncentritimit kurse vetëm 1 mashkull dhe 1 femer me vështirësi të gëlltitjes. Moshat e reja (2-6) përfitojnë më së shumti prej shërbimeve të ekipit multidisciplinar ku kemi parë se 51 raste janë të moshës 1-6 dhe 7-10, kurse vetëm 1 është 1 moshës 18-21 vjet.

Zbatimi i qasjes eklektike në një ekip multidisciplinar: studim rasti

Msc. Adela Bajrami & Bsc. Altina Limani

Ekipi multidisciplinar luan një rol kyç në mbështetjen e fëmijëve me vështirësi në zhvillim, duke ofruar ndërhyrje të koordinuar dhe të personalizuar. Ky studim rasti përshkruan punën me një fëmijë 5-vjeçar, i cili merr shërbime të logopedisë dhe terapisë së sjelljes që nga moshë 3 vjeç e 4 muaj, për shkak të vështirësive gjuhësore, mungesës së vëmendjes dhe kontrollit të impulseve. Ndërhyrja është realizuar pesë herë në javë dhe është bazuar në standardet e zhvillimit për moshën përkatëse. Fushat e ndërhyrjes kanë përfshirë zhvillimin motorik, gjuhësor, kognitiv, autonominë personale dhe zhvillimin socio-emocional. Ndërhyrja është realizuar përmes një qasjeje eklektike, të strukturuar sipas nevojave individuale të fëmijës. Gjatë periudhës së trajtimit, fëmija ka treguar progres të konsiderueshëm drejt përmbushjes së objektivave të vendosura në planin e ndërhyrjes. Ky rast evidenton rolin thelbësor të bashkëpunimit ndërdisiplinar në hartimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve të personalizuar për fëmijët me vështirësi në zhvillim.

Fjalë kyçe: ekip multidisciplinar, terapi e sjelljes, logopedi, zhvillimi i fëmijëve.

Midis Heshtjes dhe Kujdesit: Perspektiva e mësimeve dhe gjetjet e para nga Ndihma e Parë e Shëndetit Mendor

Mdc. Rineta Maliqi

Ky raport prezanton gjetjet fillestare nga tetë trajnime mbi Ndihmën e Parë për Shëndetin Mendor (NPSHM), të zhvilluara gjatë muajit maj me pjesëmarrjen e 142 mësimeve të arsimit fillor dhe të mesëm në Komunën e Prishtinës. Përmes një pyetësoi të strukturuar të plotësuar në mënyrë vullnetare nga 73 prej tyre përpara trajnimit, u analizuan perceptimet, përvojat dhe nevojat e mësimeve në lidhje me identifikimin dhe mbështetjen e nxënësve me shqetësime emocionale. Gjetjet tregojnë se problemet e shëndetit mendor janë të pranishme në mënyrë të vazhdueshme në ambientin shkollor, por shpeshherë keqinterpretohen dhe nuk adresohen në mënyrë të duhur.

Mësimeve raportojnë ndjenja pasigurie dhe mungesë përgatitjeje për të reaguar në raste të krizës emocionale, të ndikuara nga mungesa e trajnimeve specifike, protokolleve të qarta dhe mbështetjes institucionale. Raporti rekomandon integrimin sistematik të NPSHM në zhvillimin profesional të mësimeve, hartimin e protokolleve standarde për ndërhyrje dhe referim, forcimin e bashkëpunimit shkollë-familje dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike për vetë mësuesit. Ndër kufizimet e studimit përfshihen përfaqësimi i kufizuar gjeografik, përdorimi i vetëvlerësimit dhe mungesa e matjes së efekteve pas trajnimit.

Fjalë kyçe: ekip multidisiplinar, terapi e sjelljes, logopedi, zhvillimi i fëmijëve.

Ndikimi i Psikoterapisë së Kohezionit të Brendshëm në përmirësimin e aftësive vetërregulluese dhe vetëvlerësimit

Ma. Semra Salihi

Studimi ka për qëllim të hulumtoj mbi ndikimin që ka Psikoterapia e Kohezionit të Brendshëm në përmirësimin e aftësive vetërregulluese dhe vetëvlerësimit tek individët. Mostra pjesëmarrëse në hulumtim janë gjithsej 79 persona nga të cilët 60 janë femra dhe 19 meshkuj me një moshë mesatare 28.85. Kriteri i përfshirjes është që pjesëmarrësit të jenë të diagnostikuar me njërin nga çrregullimet si depresioni, ankthi, PTSD, OCD, dhe çrregullimin e përshtatjes, ndërsa kriteri i përjashtimit përfshinë dëmtime të rënda kognitive, simptoma akute psikotike, ose çdo gjendje që pengon në aftësitë e pjesëmarrësit të përfshihet kuptimisht në intervenim. Studimi është i llojit kuantitativ dhe mbledhja e të dhënave është bërë përmes anketimit me dy pyetësorët, Shkalla e Vetëvlerësimit të Rosenberg (RSS; Rosenberg, 1965) dhe pyetësori për aftësitë vetërregulluese (SSRQ; Carey et al, 2004). Mbledhja e të dhënave është bërë në dy faza, para dhe pas intervenimit (pre dhe post test). Të gjeturat nga ky hulumtim tregojnë se Psikoterapia e Kohezionit të Brendshëm është treguar efektive në përmirësimin e aftësive vetërregulluese dhe vetëvlerësimit tek mostra klinike.

Fjalët kyçe: Terapia e Kohezionit të Brendshëm, aftësitë vetërregulluese, vetëvlerësimi, psikoterapia, mirëqenia psikologjike

Mësimi i Bazuar në Lojë: Përfitimet Shumë-dimensionale

Msc. Naz Acik

Zhvillimi optimal njohës në fëmijërinë e hershme përfshin shfaqjen dhe rritjen e aftësive njohëse brenda fushave të shumëfishta (Chaput, J. P., et. al., 2016). Fushat si gjuha, kujtesa, njohja hapësinore dhe funksioni ekzekutiv luajnë një rol kritik në rezultatet afatgjata të fëmijëve; si pasojë, ndërhyrjet e synuara për të mbështetur dhe trajnuar këto fusha duhet të iniciohen gjatë fëmijërisë së hershme. Lojërat lejojnë adresimin e proceseve dhe strategjive të ndryshme njohëse dhe metakognitive të përfshira në të nxënë dhe të menduar (Hessels-Schlatter, C., 2010). Lojërat mund të jenë të ndërlikuara dhe të kushtueshme ose një mënyrë shumë e lehtë për të trajnuar zhvillimin njohës që në moshat e hershme pa e vënë re fare. Ndërsa disa lojëra janë të kushtueshme, ato gjithashtu mund të ofrojnë një mënyrë pothuajse të lehtë për t'i angazhuar fëmijët në të nxënë. Me këtë prezantim, ne do të zhytemi thellë në fushat për t'u përmirësuar përmes lojërave dhe do të eksplorojmë disa truke për të parë lojërat nga një perspektivë edukative.

Shëndeti Mendor në Dritën e Teatrit

Msc. Tana Aliaj

Që nga kohërat e lashta, teatri nuk ka shërbyer vetëm si një formë artistike, por edhe si një mjet për pastrimin emocional, një proces që Aristoteli e quajti katarsis - çlirimi i emocioneve përmes përjetimit të ndjenjave intensive. Duke u përballur me dhimbjen, frikën dhe tragjedinë në skenë, publiku i nënshtrohet një forme vetë-reflektimi që ka efekte të thella në mirëqenien mendore. Kjo fuqi transformuese e teatrit mbetet e rëndësishme edhe sot, pasi shqetësimet për shëndetin mendor zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në diskursin publik dhe akademik.

Shfaqja Braktisja e Dytë është një shembull konkret se si teatri mund të përdoret si një platformë për rritjen e ndërgjegjësimit dhe adresimin e çështjeve të ndjeshme si depresioni, ankthi, vetmia, vetëvrasja dhe përjashtimi social. Duke u përqendruar në historinë e një vajze të re jashtë një sistemi tradicional familjar dhe përball me dy forma braktisjeje - biologjike dhe sociale - drama ndërton një rrëfim bindës rreth ndikimit të mungesës së lidhjeve emocionale në shëndetin mendor.

Vepra eksploron marrëdhënien midis teatrit dhe përforcimit të ndërgjegjësimit publik mbi çështjet psikosociale, duke analizuar se si rrëfimi artistik aktivizon ndjeshmërinë dhe empatinë kolektive. Në këtë kuptim, teatri vepron jo vetëm si një mjet edukativ, por edhe si një medium terapeutik, duke u dhënë zë individëve të marginalizuar dhe duke stimuluar refleksim të thellë mbi përgjegjësinë e shoqërisë ndaj tyre. Drama paraqet jo vetëm një histori personale, por edhe një diagnozë sociale të mungesës së strukturave mbështetëse për të rinjtë vulnerabël, duke theksuar urgjencën për politika gjithëpërfshirëse dhe ndërhyrje të hershme psikosociale.

Ky prezantim synon të kontribuojë në debatin akademik mbi rolin e arteve interpretuese në shëndetin publik, duke argumentuar se teatri mbetet një nga format më të fuqishme të ndërveprimit njerëzor që mund të ndihmojë në përballimin kolektiv të traumës, vetmisë dhe përjashtimit.

Fjalë kyçe: shëndet mendor, art, dramë

Vlerësimi i Cilësisë së Arsimit në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë: Kultura e Klasës, Mësimi i Udhëhequr dhe Zhvillimi Socio-Emocional

**Tigran Shmis, Arian Musliu, Smaranda-Ioana Gliga (Vlad),
Alina Rosu, & Mrika Aliu**

Arsimi i fëmijërisë së hershme (EFH) luan një rol vendimtar në formësimin e zhvillimit kognitiv, social dhe emocional të fëmijëve. Megjithatë, në Kosovë, qasja në EFH me cilësi të lartë mbetet e kufizuar, duke kontribuar në pabarazitë në gatishmërinë për shkollë dhe rezultatet arsimore afatgjata. Ky studim vlerëson cilësinë e mësimdhënies në institucionet e EFH-së në Kosovë duke përdorur mjetin Teach ECE, i cili vlerëson tre fusha kryesore: kulturën e klasës, mësimin e udhëhequr dhe aftësitë socio-emocionale. Të dhënat u mbledhën nga 104 kopshte në të gjithë Kosovën, duke përfshirë qendrat publike, private dhe ato me bazë në komunitet.

Gjetjet nxjerrin në pah pikat e forta në kulturën e klasës, me mësuesit që nxisin mjedise mësimore mbështetëse emocionalisht dhe mbajnë pritshmëri pozitive për sjelljen. Megjithatë, mësimi i udhëhequr paraqet sfida, veçanërisht në fushat e reagimeve dhe të menduarit kritik, ku shumë mësues ofrojnë vetëm mbështetje sipërfaqësore. Zhvillimi socio-emocional ishte fusha më e dobët, me mundësi të kufizuara për fëmijët për të zhvilluar autonomi, këmbëngulje dhe aftësi bashkëpunuese. U vunë re gjithashtu pabarazi institucionale, me qendrat me bazë në komunitet që i tejkaluan institucionet publike dhe private në shumicën e fushave.

Këto gjetje nënvizojnë nevojën për programe të synuara trajnimi për mësues që përqendrohen në pedagogji interaktive, strategji reagimi dhe zhvillim të aftësive socio-emocionale. Forcimi i cilësisë së edukimit në fëmijërinë e hershme përmes reformave të politikave dhe zhvillimit profesional është thelbësor për të siguruar mundësi të barabarta mësimi për të gjithë fëmijët në Kosovë.

Fjalë kyçe: Arsimi i hershëm i fëmijërisë, Kosova, kultura e klasës, mësimi i udhëhequr, zhvillimi socio-emocional, cilësia e mësuesve, politika arsimore.

POSTER-PREZANTIMET

Këndëvështrimi i mësimdhënësve për rolin e asistentës/it në mbështetje të nxënësve me nevoja të veçanta në klasë të rregullt

Msc cand. Fatmira Maxhuni

Të gjithë fëmijët, përfshirë ata me nevoja të veçanta, gëzojnë të drejtën për arsimim në të gjitha nivelet e edukimit. Megjithëse gjithëpërfshirja është pranuar si koncept në Kosovë, zbatimi i saj vazhdon të përballet me sfida të shumta, përfshirë mungesën e stafit mbështetës. Ky hulumtim ka për qëllim të shqyrtoj këndvështrimet e mësimdhënësve për rolin dhe rëndësinë e asistentëve të nxënësve me nevoja të veçanta në klasat e rregullta.

Përmes metodës mikse, janë mbledhur të dhëna nga një pyetësor me 79 mësimdhënës nga 20 komuna të Kosovës dhe intervista gjysmë të strukturuar me 7 mësimdhënës që punojnë me asistentë në klasë.

Rezultatet tregojnë se mësimdhënësit janë përgjithësisht të hapur për bashkëpunim me asistentë dhe e vlerësojnë rolin e tyre si të domosdoshëm për përfshirjen efektive të nxënësve me nevoja të veçanta. Megjithatë, përfshirja e kufizuar e asistentëve në praktikë krijon vështirësi për të gjithë akterët përfshirë mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.

Ky studim ofron rekomandime konkrete për rritjen e mbështetjes institucionale dhe përmirësimin e kapaciteteve të asistentëve në funksion të një edukimi më gjithëpërfshirës në Kosovë.

Fjalët kyçe: Nxënës, mbështetje, asistentë, arsim gjithëpërfshirës

Ndërlidhja Mes Tipareve Të Personalitetit Dhe Stileve Të Lidershipit Te Rinia E Hershme

Bsc. Kaltrina Rrafshi Bsc. Drenushë Krasniqi

Lidershipi/udhëheqja është një marrëdhënie ndikimi mes liderëve dhe ndjekësve, të cilët synojnë arritjen e qëllimeve të përbashkëta (Rosari, 2019). Është proces i ndikimit shoqëror, ku lideri maksimizon përpjekjet e të tjerëve për arritjen e qëllimit (Kruse, 2013).

Personaliteti është integrimi i përvojave subjektive të një personi dhe modeleve të sjelljes. Është një strukturë e organizuar e tipareve dhe përvojave të shumta që ndikojnë njëra-tjetrën (Kernberg, 2016).

Ky studim ka si qëllim kryesor të kuptoj ndërlidhjen mes lidershipit dhe personalitetit, me fokus të veçantë në disa lloje të lidershipit dhe në teorinë e personalitetit të njohur si Pesa e Madhe (Big Five).

Për këtë studim, ne kemi aplikuar 2 pyetësorë te 135 të rinj të moshës 19-23 vjeç në vende të ndryshme të Kosovës. Pyetësori i parë është pyetësori për lidershipin, Akron Leadership Questionnaire, i cili përmban 25 iteme dhe përfshin gjashtë stile të lidershipit. Pyetësori i dytë është pyetësori i personalitetit, Big 5 Personality Questionnaire, i cili përmban 50 iteme dhe mat pesë tipare të personalitetit. Për përpunimin e të dhënave është përdorur Paketa Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS).

Kemi arritur të kuptojmë se mes dy variablave ekziston një ndërlidhje pozitive, dhe personaliteti ka ndikim mbi lidershipin, duke vërejtur ndërlidhje të disa tipareve me llojet specifike të lidershipit. Po ashtu, është arritur në përfundimin se disa të dhëna sociodemografike si mosha apo gjinia nuk kanë ndikim në tiparet e personalitetit, ndërsa statusi i punësimit duket se ndikon mbi stilin e lidershipit.

Tiparet e personalitetit nuk janë elemente kyçe që ndikojnë në stilin e lidershipit të një të riu ngjajshëm me studime tjera. Nuk u gjetën dallime moshore dhe gjinore ngjajshëm me studime tjera në këto komponentet por u gjetën dallime varësisht statusit të punësimit.

Fjalët kyçe: lidershipi, personaliteti, Pesa e Madhe, rinia e hershme.

Përvojat e Familjarëve të Fëmijëve në Spektrin e Autizmit

Eneda Gorani

Ky studim eksploron përvojat e familjeve me fëmijë që janë të diagnostifikuar në spektrin e autizmit, duke u fokusur në sfidat, përfitimet dhe mbështetjen që ato marrin gjatë perkujdesjes për fëmijët e tyre. Qëllimi i studimit është të analizojë aspekte të ndryshme të jetës së këtyre familjeve, përfshirë situatat sociale dhe ekonomike që ndërliken me kujdesin për një fëmijë në spektrin e autizmit, si dhe të identifikojë strategjitë që ato përdorin për t'u përballur me këto sfida. U përdoren intervistat gjysmë të strukturuar me 5 familjarë. Gjetjet e studimit tregojnë se familjet përballen me vështirësi të mëdha financiare dhe mungesë të mbështetjes profesionale, duke përfshirë staf të kualifikuar në shkollë dhe asistentë të nevojshëm. Mungesa e shërbimeve të specializuara dhe kostot e larta përballen nga këto familje e përkaqësojnë akoma më tej situatën. Studimi gjithashtu evidenton një mungesë të mbështetjes emocionale dhe mbështetjeve të duhura për prindërit që përballen me sfidat e kujdesit të përditshëm.

Fjalët kyçe: spektri i autizmit, familjarë, përvoja, mbështetje

Kur Autizmi Maskohet: Dallimet Gjinore në Diagnostikimin e Vajzave me Çrregullim të Spektrit të Autizmit (ÇSA)

Jonida Osmani

Diagnostikimi i vajzave me çrregullim të spektrit të autizmit shpesh ndodh më vonë sesa tek djemtë, duke ndikuar negativisht në zhvillimin e tyre social, emocional dhe akademik (Lai & Baron-Cohen, 2015) . Kjo vonesë nuk është vetëm pasojë e dallimeve biologjike, por edhe e ndikimit të normave dhe stereotipeve gjinore në mënyrën se si interpretohen simptomat. Sipas Gould (2017) vajzat kanë më shumë gjasa të përdorin strategji maskimi, si imitimi i sjelljeve sociale të bashkëmoshatarëve, për të fshehur vështirësitë e tyre sociale.

Këto strategji shpesh i bëjnë simptomat e tyre më pak të dukshme për profesionistët. Interesat e kufizuara tek vajzat, si dashuria për kafshët apo vallëzimi, janë më të pranueshme shoqërisht dhe rrallë perceptohen si sjellje autike, ndryshe nga interesat më të pazakonta që shfaqin djemtë (Hiller et al, 2014) . Studimet sugjerojnë se ky “maskim i autizmit” tek vajzat çon në diagnostikim të vonuar ose të pasaktë dhe shpesh ato marrin diagnoza si ankth, çrregullime të humorit apo çrregullime të të ushqyerit (Hull et al, 2017).

Instrumentet diagnostikuese aktuale, janë zhvilluar kryesisht bazuar në karakteristikat e djemve dhe nuk janë gjithmonë të ndjeshme për të kapur mënyrën unike të shfaqjes së simptomave tek vajzat (Ratto et al , 2018) . Ky poster shqyrton dallimet gjinore në shfaqjen e simptomave të ÇSA, efektin e maskimit dhe ndikimin e perceptimeve sociale në vlerësimet klinike. Duke përfshirë gjetje nga literatura dhe përvoja personale të grave të diagnostikuara në moshë madhore, qëllimi është të rritet ndërgjegjësimi mbi nevojën për mjete diagnostike më të ndjeshme ndaj gjinisë dhe për ndërhyrje të hershme që mbështesin vajzat në mënyrë të hershme dhe më efektive.

MIRËNJOHJE

QHPSM u është mirënjohëse të gjithë atyre që përkrahën realizimin e këtij edicioni:



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE
PRESIDENT REPUBLIKA KOSOVO - URED
PREDSEDNICE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

PËRKRAHUR NGA
UNFPA

 Santefarm

Libraria
Dukagjini

